

1. Sigurimet e pronës

a) Bizneset

Atlantik Sh.a ofron këtë sigurim për: pasurinë e paluajtshme (njësitë tregtare dhe industriale), pasurinë e luajtshme, e cila përfshin (Makineri, pajisje, inventar ekonomik, lëndë e parë, mallrat etj). Atlantik Sh.a ju dëmshpërblen për humbjen, dëmtimin ose shkatërrimin e pasurisë së siguruar në mënyrë të papritur, të paparashikuar dhe aksidentale si pasojë e: zjarrit, rrufesë, shpërthimit, përplasjes ose rënies së një avioni, pjesëve ose ngarkesës së tij, përpjekjeve për shuarjen e zjarrit, prishjeve ose lëvizjeve në lidhje me çdonjërin prej ngjarjeve të mësipërme, tërmetit, përmbytjes, stuhisë, thyerjes së xhamave, akteve terroriste, grevave, trazirave civile etj. Primet për këtë sigurim variojnë nga 0,2% deri në 1% të shumës së siguruar, në varësi të biznesit që ushtrohet.

b) Sigurimi i pronës private

Atlantik Sh.a ofron këtë sigurim për: pasurinë e paluajtshme, e cila përfshin (banesat, njësitë tregtare dhe industriale), pasurinë e luajtshme, e cila përfshin (Makineri, pajisje, inventar ekonomik, lëndë e parë, mallrat etj). Atlantik Sh.a ju dëmshpërblen për humbjen, dëmtimin ose shkatërrimin e pasurisë së siguruar në mënyrë të papritur, të paparashikuar dhe aksidentale si pasojë e: zjarrit, rrufesë, shpërthimit, përplasjes ose rënies së një avioni, pjesëve ose ngarkesës së tij, përpjekjeve për shuarjen e zjarrit, prishjeve ose lëvizjeve në lidhje me çdonjërin prej ngjarjeve të mësipërme, tërmetit, përmbytjes, stuhisë, thyerjes së xhamave, akteve terroriste, grevave, trazirave civile etj. Primet për këtë sigurim variojnë nga 0,05% deri në 1,5% e shumës së siguruar, në varësi të objektit si dhe llojeve të rreziqeve që do të sigurohen.

2. Sigurimi nga ndërprerja e biznesit

Sigurimi i biznesit është për të gjithë sipërmarrësit dhe administratorët e bizneseve të ndryshme pavarësisht llojit dhe përmasave të aktivitetit.

Nëpërmjet këtij produkti, Atlantik Sh.a mbulon shpenzimet si pasojë e ndërprerjes së aktivitetit të biznesit nga zjarri apo rreziqet shtesë të tij duke siguruar fitimin neto si dhe kostot fikse.

Në rastet e dëmtimit të pasurisë, ju duhet të përballoni edhe pasojat që vijnë nga ndërprerja e veprimtarisë ekonomike: mungesa e të ardhurave dhe qarkullimit të parasë. Për këtë qëllim, Atlantik Sh.a ofron të gjitha mundësitë për vazhdimin e qetë të punës tuaj.

Primet për këtë sigurim variojnë nga 0,2% deri në 1% të shumës së siguruar, në varësi të biznesit që ushtrohet.

3. Sigurimi i mallit në transport.

Përmes këtij sigurimi, Atlantik Sh.a mbulon të gjitha rreziqet, ndaj të cilave janë të ekspozuara mallrat gjatë transportit. Të gjitha humbjet apo dëmtimet aksidentale dhe të pa paramenduara apo keqdashëse; zjarr, shpërthim; aksidente të mjeteve të transportit; shkarkimin e mallit në një port tjetër në rast fatkeqësie; sakrificën e avarisë së përgjithshme, shpenzime për shpëtimin e ngarkesës, dëmi nga tërmeti, vullkani, rrufeja, dëmtimi i mallrave nga uji në bordin e anijes, dëmtime dhe humbje totale të pakove gjatë ngarkim-shkarkimit.

Për kompanitë e transportit që punojnë për të tretë, Atlantik Sh.a ofron produktin CMR: sigurimi 100% i përgjegjësisë së transportuesit.

4. Mjetet e transportit:

- a. Transport tokësor: përfshin transportin automobilistik dhe atë hekurudhor;— Transport detar: ku pranohen të gjitha llojet e anijeve që plotësojnë kushtet e Institute Cargo Clause-Londër;—
- b. Transport ajror: ku pranohen kërkesat për sigurimin e mallit për avionë të licencuar; Primet për këtë sigurim variojnë Për transporte tokësore brenda Europës nga 0.10% deri në 0.40% të shumës së siguruar.
- c. Për transporte detare brenda Europës nga 0.10% deri në 0.40% të shumës së siguruar. Për transporte ajrore 0.08% deri në 0.30 % të shumës së siguruar.

5. Sigurimi i avionëve Atlantik Sh.a e ofron këtë sigurim për avionë pasagjerësh dhe mallrash, helikopterë ushtarakë dhe civilë.

Sigurimet që ofrohen janë:

- a. Sigurim trupi, pjesëve të këmbimit dhe përgjegjësive ligjore,
- b. Sigurimi i përgjegjësive të avionit nga lufta, pengmarrja dhe përgjegjësi të tjera të kësaj natyre
- c. Sigurimi i trupit të avionit nga lufta dhe rreziqet që rrjedhin prej saj
- d. Sigurimi i pjesës së zbritshme
- e. Mbulimi i përgjegjësive ndaj të tretëve

6. Sigurimi i anijeve .

Sigurimi i Trupit të Anijes dhe Makinerive (Hull & Machinery) nga rreziqet e detit ose ujrave të tjerë të lundrueshëm, zjarri, shpërthimi, vjedhja me dhunë nga persona të tjerë jashtë anijes, hedhja e ngarkesës në det, pirateria, kontakti me mjetet e tjera

lëvizëse në tok ë, dok apo port, tërmeti apo shpërthimi vullkanik, aksidentet gjatë ngarkim-shkarkimit, thyerja e aksit të helikës, neglizhenca e kapitenit, revolta e kapitenit apo oficerëve dhe ekuipazhit, kontakti me helikopterë apo rënie të pjesëve nga objekte fluturuese, përgjegjësinë e përplasjes, avari e përgjithshme etj.

Sigurimi i Përgjegjësisë P&I (Protection & Idemnity) nga plagosja, sëmundja apo vdekja e një detari, pasagjeri apo pale të tretë, shpenzimet e riatdhesimit të një detari apo oficeri, dëmshpërblimi për papunësinë si pasojë e përplasjes së anijes, shpenzimet për riatdhesimin e refugjatëve, shpëtimin e jetës, humbjen apo dëmtimin e pasurisë, ndotjen, përgjegjësinë e mbytjes, përgjegjësisë për dëmtimin e mallit, shpenzimet e shpëtimit, avarisë së përgjithshme, konfiskimin e anijes, dëme të shëndetit apo pronës të shkaktuara palëve të treta, proceset gjyqësore etj.

7. Sigurimet financiare.

Janë sigurimet që i ofrohen bankave, agjencive të këmbimit, institucioneve të tjera financiare, por edhe për veprimtari të tjera që kanë qarkullim vlerash monetare:

- a. **Sigurimi Kompleks i Bankave, BBB** Kjo kontratë ofron mbulim kompleks për Bankat dhe fondacionet e mikrokredive.
Përmes këtij produkti, mbulohe rreziqe si: Pandershmëritë e punonjësve. Godinat (Drejtoria dhe Agjencitë) . Paratë në Kasafortë. Paratë në Tranzit. Çequet e imituara. Paratë e falsifikuara .Pajisjet dhe inventari ekonomik gjate tentativës për grabitje.
- b. **Sigurimi i parave në kasafortë** Atlantik Sh.a merr përsipër t'ju dëmshpërblejë për humbjen apo dëmtimin e pasurisë, si rrjedhojë e vjedhjes përmes hyrjes dhe daljes forcërisht ose me dhunë nga objekti që ju do të siguron. Ky sigurim aplikohet për bankat, shoqëritë e këmbimit valutor si dhe të gjitha shoqëritë e mëdha që mbajnë gjendje parash në ambientet e tyre.
- c. **Vjedhja dhe grabitja e vlerave monetare në:** Kasafortë. ATM (Automatic Teller Machine). Sportele.
- d. **Sigurimi i parave gjatë transportit:** Nëpërmjet kësaj kontrate, Atlantik Sh.a ju mbulon në sigurim nga rreziku i vjedhjes dhe grabitjes së vlerave monetare gjatë transportit të tyre.
Ky sigurim aplikohet për bankat, shoqëritë e këmbimit valutor si dhe të gjitha shoqëritë e mëdha që transportojnë shuma parash për aktivitetin e tyre. Ky produkt konsiston në dëmshpërblimin e dëmeve të shkaktuara nga vjedhja apo grabitja e vlerave monetare:
 1. gjatë transportit.
 2. nën ruajtjen e punonjësve.
 3. nën kujdesin e shoqërive transportuese

Tarifat për këtë sigurim ndryshon në varësi të shumës së siguruar, mënyrës së transportit dhe masave të marra të sigurisë.

8. Sigurimet e Garancive. Përmes këtij produkti, për të gjitha kontratat dhe garancitë e siguruara Atlantik Sh.a mbulon vlerën financiare të siguruar, në rast se ka shkelje ose mospërfundim të kontratës midis dy individëve ose bizneseve.

- 1. Sigurimi i kreditit.** Ky sigurim mbulon rrezikun e mospagesës për shkak të paaftësisë pagueuse, kreditë e eksportit, kreditë e shlyera me këste, kreditë hipotekore, kreditë bujqësore si dhe kundërgarancitë me Bankat. Atlantik Sh.a garanton për integritetin e aplikantit. Sigurimi i Garancive të drejtpërdrejta dhe të tërthorta.
- 2. Garanci Oferte:** është garantimi i palës ofertuese për paraqitjen pranë Autoritetit kontraktor;
- 3. Garanci Kontrate:** është produkt i nevojshëm për palët pjesëmarrëse në një kontratë të caktuar, shkelja e së cilës çon në lindjen e detyrimeve të ndryshme;
- 4. Garanci Paradhënie:** çdo firmë mund të marrë paradhënie nga Autoriteti Kontraktor për zbatimin e kontratës dhe për çdo shumë që i paguan kontraktuesit, ky autoritet i kërkon një garanci.
- 5. Garanci Doganore:** Atlantik Sh.a garanton për integritetin e personit fizik/juridik karshi Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave në përputhje me ligjet dhe rregullat që i kërkojnë nga D.P.D për dhënie licence/leje ushtrimi veprimtarie për: Magazinë Doganore dhe Agjensi Doganore.
- 6. Garanci Cilësie:** Atlantik Sh.a e ofron këtë shërbim për të garantuar se një firmë ndërtimi, shërbimi etj, do të kryejë punimet materiale sipas cilësisë së kontraktuar, sipas konstruksionit, funksioneve etj, të kontraktuara deri në përfundimin e objektit apo projektit. Në çdo rast defekti, Atlantik Sh.a garanton zëvendësimin e materialit apo të punimeve të rezultuara si jashtë standardit të kontratës deri në limitet/shumën e përcaktuar në garanci.
Primet vjetore për Sigurimet e Garancive variojnë nga 0.5% deri në 6 % e shumës së siguruar në varësi të riskut që ka klienti.

9. Sigurimi i bujqësisë dhe blegtorisë .

Ky është një produkt i dizenuar për të gjithë fermerët dhe pronarët e bizneseve bujqësore dhe blegtorale nisur nga fakti se biznesi bujqësor dhe blegtoral është edhe më shumë i ekspozuar ndaj rreziqeve natyrore veçanërisht si pasojë e ndryshimit të kushteve klimatike globale.

Përmes kësaj police sigurohen ndërtesa, makina dhe makineri bujqësore, investimet në bujqësi, prodhimi bujqësor, serat, linja dhe teknologji prodhimi blegtoral, kafshët bujqësore dhe kafshë me vlera të veçanta përdorimi, shpendët, baza ushqimore. Sigurimi i bujqësisë dhe Blegtorisë mbron biznesin bujqësor dhe atë blegtoral nga

zjarri, vjedhja, rreziqet natyrore, sëmundjet, dëmtimet dhe helmimet aksidentale. Tarifat për këtë sigurim variojnë nga 0,15% deri në 6,0% të shumës së siguruar, në varësi të objektit si dhe llojeve të rreziqeve që do të sigurohen.

10. Sigurimi i Përgjegjësive I mbrojnë firmat nga humbjet që mund të mos jenë në gjendje t'i paguajnë në mënyra të tjera. **Sigurimi i përgjegjësive publike** Ky sigurim ofrohet për të mbuluar të siguruarin nga dëmtimet trupore dhe pasurore që u shkakton personave të tretë përmes veprimtarisë prodhuese, ndërtuese dhe përdoruese në ambientet e tij. Tarifat për këtë lloj sigurimi janë në varësi të veprimtarisë, procesit të punës, qarkullimit, kufijve të dëmshpërblimit por mesatarisht aplikohet një tarifë nga 0,1% deri në 0,35% e limitit të përgjegjësive. **Sigurimi i përgjegjësive profesionale** Ky sigurim ofrohet për të mbuluar të siguruarin në rast dëmtimesh që ai i shkakton shëndetit ose pronës së të tretëve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij profesionale ose gjatë këshillimit të të tretëve. **Ky është një produkt i hartuar veçanërisht për profesione si:** Ekonomistët dhe përfaqësuesit e auditit. Arkitektët dhe inxhinierët. Organizuesit e ankandëve, shoqëritë imobiliare, inspektorët dhe vlerësuesit. Doktorët, dentistët, ndihmës mjekët, okulistët. Spitalet dhe shtëpitë e të moshuarve. Agjentët e sigurimit dhe këshilltarët e investimeve. Farmacistët. Avokatët. Noterët. Profesionet e reja ne te cilat përfshihen: konsulentët e publicitetit, bizneset e teknologjisë së informacionit, media dhe bizneset e telekomunikacionit, terapisë aromatike, refleksikologjistët, konsulentë fitnesi, trajnues privat e të tjerë të këtij lloji. Tarifat për këtë sigurim varen nga një numër faktorësh duke përfshirë kufirin e dëmshpërblimit që do të sigurohet, masa dhe qëllimi i biznesit ose praktika dhe shkalla e rrezikut që lidhet me aktivitetet e tij. Tarifa mesatare e këtij sigurimi është 2% e të ardhurave totale të biznesit që ushtron klienti. **Sigurimi i përgjegjësive së punëdhënësit.** Punëdhënësi mund të behet i detyrueshëm të kompensojë punonjësin e dëmtuar ose trashëgimtarët e tij në rast vdekje, për një lëndim aksidental që shkaktohet në orar të punës, nëse ka ose jo neglizhencë nga punëdhënësi ose jo. Tarifat për këtë sigurim variojnë nga 0,25% - 0,35% e shumës totale të pagave gjatë një viti. **Sigurimi i përgjegjësive së produktit.** Ky produkt është i domosdoshëm për të gjithë biznesmenët, prodhuesit, shitësit me shumicë dhe pakicë të një malli të caktuar. Përmes këtij produkti, Atlantik Sh.a ofron mbulimin me sigurim të biznesit për përgjegjësinë e produkteve që prodhohen apo tregohen. Ky sigurim mbulon veprimtarinë e prodhuesve, duke dëmshpërblyer konsumatorët e këtij produkti, në rast se ata dëmtohen gjatë konsumimit të produktit. Dëmet që mbulohen mund të jenë fizike, aksidentale sikurse edhe dëmtime të pronës materiale të cilat ndodhin gjatë periudhës së sigurimit dhe të shkaktoara nga produktet e shitura, siguruara, shpërndara, instaluara, të nxjerra, të riparuar, të alternuara, të trajtuara ose të testuara nga i siguruari. Tarifat variojnë sipas kufijve të mbulimit të përgjegjësive dhe xhiron vjetore të Siguruarit. **Sigurimi i përgjegjësive së hoteleve dhe restoranteve.** Kjo policë sigurimi është hartuar posaçërisht për pronarët, administratorët e hoteleve dhe restoranteve për sigurimin e të gjithë përgjegjësive që rrjedhin prej veprimtarisë së

tyre. Ky sigurim mbulon dëmin fizik që mund t'i shkaktohet ndërtesës dhe përgjegjësinë publike që rrjedh nga ushtrimi i veprimtarisë hoteliere. Në rastin e hoteleve kemi të bëjmë me një policë komplekse, pasi janë disa rreziqe të cilat teknikisht dhe financiarisht trajtohen në një policë të vetme sigurimi. Tarifat për këtë sigurim varen nga një numër faktorësh duke përfshirë kufirin e dëmshpërblimit që do të sigurohet. Tarifa mesatare është 0,2% e limitit total të përgjegjësisë.

11.Sigurimet inxhinierike .

Investimi juaj është i ekspozuar në mënyrë konstante kundrejt eventeve të papritura dhe të paparashikuara, duke filluar që nga kushtet e motit dhe të papriturat e shtresave të nëntokës, mbi të cilën ju ngrini themelet e veprave tuaja dhe deri tek pakujdesitë e kapitalit human, në zbatimin me përpikmëri dhe rigorozitet të specifikave të projektit, rregullave të sigurimit në ndërtim, montim etj.

Për të ndarë këtë risk juve ju nevojitet një partner. Këtë partner ju mund ta gjeni tek Atlantik Sh.a, i cili është i gatshëm të jetë i vëmendshëm kundrejt detajeve dhe eventeve të paparashikuara, në mënyrë që ju të ecni përpara për plotësimin dhe arritjen në kohë të realizimit të projekteve tuaja.

1. Sigurimi i të gjitha rreziqeve në ndërtim (Constructors' All Risk).

Ky produkt është për të gjithë ndërtuesit e pallateve, fabrikave, uzinave, aeroporteve, urave, autostradave. Polica e sigurimit ofron mbulimin në sigurim nga të gjitha rreziqet për fazën e ndërtimit të objekteve dhe gjithashtu edhe për një afat garancie pas përfundimit të punimeve. Mbulimi përfshin si dëmet e pësuar nga i siguruari (kontraktuesi apo nënkontraktuesi i punimeve), ashtu edhe dëmet që i siguruari mund t'i shkaktojë të tretëve.

Tarifat për këtë sigurim variojnë nga 0,05% deri në 0,6% e shumës së siguruar, në varësi të llojit të objektit, natyra e objektit dhe kushtet e ndërtimit, vlera e punimeve të kontraktuara dhe makinerive të punës, limiti i përgjegjësisë si dhe nga kohëzgjatja e ndërtimit dhe afatit të garancisë.

2. Sigurimi i të Gjitha Rreziqeve Në Montim (Erection All Risk). Nëpërmjet kësaj police sigurimi Atlantik Sh.a merr përsipër të paguajë për dëmtimet e punimeve në të gjitha fazat e montimit të makinerive dhe pajisjeve në objektet industriale. Gjithashtu, ne paguajmë edhe për dëmtimet ndaj palëve të treta, si për ato trupore ashtu dhe për ato pasurore, gjithashtu dhe shpenzimet për pastrimin e mbeturinave që shkaktohen nga ndodhja e një rasti sigurimi.

Tarifat për këtë sigurim variojnë nga 0,1% e shumës së siguruar deri në 0,5% e shumës së siguruar, në varësi montimeve që do të kryhen.

3. Sigurimi i Makinerive (MI) Kjo është polica përmes së cilës sigurohen makineritë në njësitë industriale. Ne marrim përsipër të riparojmë ose zëvendësojmë humbjet ose dëmtimet fizike që mund të pësojnë makineritë në mënyrë të papritur dhe aksidentale gjatë procesit të punës. Tarifat për këtë

sigurim variojnë nga 0,2% deri në 0,5% e shumës së siguruar, në varësi montimeve që do të kryhen.

12.Sigurimet Motorike për biznesin.

1. Sigurimi TPL.

Ky sigurim përfshin mbulimin e shpenzimeve si pasojë e dëmeve materiale, shëndetësore dhe pasurore të shkaktuara ndaj palëve të treta, për shkak të qarkullimit të mjetit motorik të siguruar. Në kuadër të ligjit “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” çdo automjet që qarkullon brenda territorit të Republikës së Shqipërisë duhet të jetë i pajisur me policën TPL (Sigurimi i Detyrueshëm i Mbajtësit të Mjetit Motorik për Përgjegjësinë Civile ndaj Palëve të Treta). Primi për këtë sigurim ndryshojnë në varësi të specifikave të mjetit motorik. Përmes këtij produkti, Atlantik Sh.a mbulon përgjegjësinë civile të mbajtësit të mjetit motorik, në përputhje të plotë me parashikimin e Ligjit.

2. Sigurimi KASKO

Përmes këtij sigurimi, Atlantik Sh.a mbulon:

- a. Dëmtimet aksidentale:
- b. përplasja e automjetit me një objekt fiks ose të lëvizshëm,
- c. përmbysja e mjetit motorik;
- d. Thyerja e xhamave: thyerja e xhamave të përparmë, të pasmë, anësorë, të tavaneve të hapur, shkaktuar këto nga goditja e një objekti të lëvizshëm;
- e. Zjarri, rrufeja, eksplozioni: dëmet e shkaktuara nga zjarri, eksplozioni dhe rrufeja;
- f. Katastrofa natyrore: dëmet e shkaktuara nga stuhia, breshëri, dëborë, tufani, përmytja, vërshimi dhe dëmet e shkaktuara në mjetin motorik nga rënia e objekteve të ndryshme që ndodhin si pasojë e katastrofave natyrore;
- g. Vjedhja, tentativë për vjedhje: dëmet që vijnë si pasojë e veprimeve të përvetësimit në mënyrë të fshehtë të mjetit motorik të siguruar, nga një ose disa persona i të gjithë automjetit (vjedhje totale) ose i disa pjesëve të tij (vjedhje e pjesshme). Në këtë rrezik përfshihen gjithashtu edhe dëmet si pasojë e veprimeve që kanë synuar vjedhjen e mjetit motorik por që nuk kanë arritur të kryhen.
- h. Dëmtime në parkim (pa autor) : dëmet që pëson mjeti motorik gjatë qëndrimit i parkuar diku dhe nuk dihet shkaktari i demit.
- i. Dëmtimi nga aktet keqdashëse: dëmet që shkaktohen nga aktet keqdashëse mbi mjetin motorik të siguruar gjatë qëndrimit ose qarkullimit të tij, duke filluar nga dëmtimet keqdashëse e deri tek dëmtimet dhe akte të tjera përfshirë edhe ato terroriste.

Primi për këtë sigurim ndryshon në varësi të specifikave të automjetit, shumës së siguruar, mbulimeve të zgjedhura nga klienti dhe kohëzgjatjes së kontratës së sigurimit.

3. Sigurimi Kontrata Kufitare

Është polica e detyrueshme e sigurimit me të cilën duhet të pajiset çdo automjet me targa të huaja që qarkullon në Shqipëri. Kontrata Kufitare mbulon përgjegjësinë ndaj palëve të treta për mjetet motorike me targë të huaj që qarkullojnë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Përmes këtij produkti, Atlantik Sh.a mbulon përgjegjësinë civile të mbajtësit të mjetit motorik, në përputhje të plotë me parashikimin e Ligjit lidhur me dëmet materiale, shëndetësore dhe pasurore të shkaktuara ndaj palëve të treta për shkak të qarkullimit të mjetit motorik të siguruar. Këtu përfshihen edhe dëmet shëndetësore që pësojnë pasagjerët si dhe ato pasurore. Tarifat për këtë sigurim janë të përcaktuara nga Ministria e Financave dhe janë të njëjta për të gjitha kompanitë e sigurimit. Ato ndryshojnë në varësi të kategorisë të mjetit motorik dhe kohëzgjatjes së kontratës së sigurimit (e cila mund të jetë për 15, 30, 45 ditë, 6 muaj apo 1 vit).

13.Sigurimi nga aksidentet Personaler.

a. Sigurimi nga aksidentet i punonjësve

Çdo individ mund të sigurohet nga aksidentet, pavarësisht nga mosha apo aktiviteti i përditshëm që kryen. Sigurimi nga aksidentet mbulon paaftësinë e përkohshme, paaftësinë e përhershme ose humbjen e jetës të siguarit të shkaktuar nga aksidente të ndryshme që mund të ndodhin gjatë ushtrimit të veprimtarisë profesionale ose jashtë saj si edhe për shkak të ndikimit të disa faktorëve apo ngjarjeve të cilat janë klasifikuar si aksidente dhe që janë: helmimi, mbytja, ngrirja, sforcimet fizike etj .Në rast se si pasojë e aksidentit individi humb jetën apo pëson paaftësi totale të përhershme,

b. Sigurimi nga aksidentet i nxënësve dhe studentëve

Nepermjet polices per nxenes dhe studente ofrohet **mbrojtje fiananicare** ne rast semundje dhe aksidenti. Nxenesi apo studenti i siguruar me kete police ka te mbuluara shpenzimet mjekesore (pa asnje perjashtim) deri ne 100,000 Leke. Gjithashtu kjo police parashikon nje kompensim ne Shumen 500,000 Leke ne rast se fatkeqesisht prindi humbet jeten apo aftesine per te punuar. Primi i polices eshte 1500 lek/vit per person nese ofrohet ne grupe mbi 10 veta. Primi i polices do te jete 5000 lek/vit per person nese blerja eshte individuale.

